

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-259161/22 dt. 30.11.2022, të pronarit Remzi Krasniqi nga Glllogoci me adresë rr. “14 Qershori” nr. 62, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të shndërrimit të hapësirës banuese në hapësirë afariste e cila ndodhet në kuadër të ndërtesës në bashkëpronësi me etazhitet B+P+4, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 24.05.2023 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarit Remzi Krasniqi nga Glllogoci, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-259161/22 dt. 30.11.2022, për përdorimin e hapësirës së shndërruar nga hapësira banuese në hapësirë afariste, sipas Vendimit nr. 05-351-278082 të datës 24.02.2015 e cila ndodhet në kuadër të ndërtesës në bashkëpronësi me etazhitet B+P+4, në Lagjen “Ulpiana”, rr. “Kosta Novakoviç” nr. i hyrjes 23, në Prishtinë.

II. Ndërtesa/hapësira, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore nr. 05-351-278082 të datës 24.02.2015, dokumentacionit ndërtimor dhe Njoftimit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa/hapësira mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

V. Pjesë përbërëse e kësaj certificate të përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari Remzi Krasniqi nga Glllogoci, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-259161/22 dt. 30.11.2022, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për hapësirën e shndërruar nga hapësira banuese në hapësirë afariste, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Drejtoria e Inspekcionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr. 391/02-182915/22 dt. 25.11.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspekcionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e udhëzimit administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f

- Vendimin nr. 05-351-278082 të datës 24.02.2015 për lejimin e ndërrimit të destinimit të përdorimit të hapësirës banuese në hapësirë afariste në katin përdhës të ndërtesës shumëbanesore me etazhitet B+P+4 në Lagjen “Ulpiana”, rr. “Kosta Novakoviç” nr. i hyrjes 23 në Prishtinë.
- Aktvendimin me nr. 05-351-278082 të datës 11.02.2015, mbi caktimin e taksës administrative për lejen e ndërrimit të destinimit të përdorimit të hapësirës baneose në hapësirë afariste.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtës, Arbër Canhasi bsc. i ndërtimtarisë - udhëheqës e vendndërtimit, Avni Ramadani msc i arkitekturës - mbikëqyrës

për arkitekturë, Jeton Canhasi idn - mbikëqyrës për strukturë, Adnan Bektashi idn - mbikëqyrës për hidro-instalime, Besim Abrashi ide - mbikëqyrës për instalime elektrike.

- Protokollet e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografji gjatë procesit të ndërtimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Njoftimit mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesës nga Inspekcioni me referencë 09 Nr. 391/02-182915/22 dt. 25.11.2022, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e pronarit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-259161/22 dt. 30.11.2022 ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, punët zeytare konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Vendimin e Lejes së ndërrimit të destinimit të hapësirës 05-351-278082 të datës 24.02.2015. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi.

Në Njoftimin mbi inspektimin final të lëshuar nga Drejtoria e Inspekcionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet për ndërrimin e destinimit janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që të vazhdoi procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që hapësira me destinimin banim e shndërruar në hapësirë afariste, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkesit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-259161/22 DT. 24.05.2023**


Zyrtari:

Arbër Morina



Udhëheqëse e sektorit

Nazife Krasniqi



Drejtori:

Arber Sadiki

